



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr. 152/2020

GJYKATA APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË – Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar kolegj, Liridon Maloku dhe Rustem Thaqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit [“E...”], sh.p.k., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, të cilën me autorizim e përfaqëson [A.D], avokat nga Prishtina, kundër të paditurit [A.S] nga Prishtina, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit [A.Q], avokat nga Prishtina, që të dy palët në kontest aksionarë ne Shoqërinë Tregtare [“E1...”] sh.p.k, me objekt kontesti, kthimi i dividendës dhe kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 471,648.03€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.117/17, të datës 03.08.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.10.2021, mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit [“E...”], sh.p.k., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.117/17, të datës 03.08.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit [“E...”], sh.p.k., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, aksionarë ne Shoqërinë Tregtare [“E1...”] sh.p.k, e paraqitur kundër të paditurit [A.S] nga Prishtina, aksionarë ne Shoqërinë Tregtare [“E...”] sh.p.k, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet pala e paditur që të deponoj në shoqërinë [“E...”] sh.p.k shumën e mjeteve prej 471,648.03€ me kamatë ligjore prej 8% e cila fillon të rrjedh nga data 19.11.2016 e deri në pagesën definitive. Ndërsa në piken II të dispozitivit është detyruar pala paditëse që palës së paditur t’ia paguaj shumën prej 2,700.00€ në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi [“E1...“], sh.p.k., me seli në Tiranë Republika e Shqipërisë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit pas shqyrtimit të pretendimeve sipas kësaj ankesë, ankesën ta aprovoje si të bazuar dhe Aktgjykimin I.EK.nr.117/17, të datës 03.08.2020 ta ndryshoje ashtu që kërkesëpadia e paditësit të miratohet në tërësi ose aktgjykimin të prishë dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Ne përgjigjen në ankesë i autorizuari i të paditurit ka kërkuar nga Gjykata Apelit që ankesën e palës paditëse ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 505.1 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi [“E1...“], sh.p.k., me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, me datën 07.03.2017 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurit [A.S] nga Prishtina, për shkak të kthimit të dividendës dhe kompensimit të dëmit, ku i ka propozuar gjykatës që ta aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit, kthim të dividendës të autorizim të bartjes së objektit ndërtimor në emër të shoqërisë, dhe të urdhërohet i padituri t’ia kthej shumën prej 500,000.00€, me kamatë ligjore, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se pala paditëse është Shoqëri nga Republika e Shqipërisë dhe se ka bërë investime përmes blerjes së aksioneve nga Shoqërinë [“E...“] sh.p.k, me seli në Prishtinë. Po ashtu pala paditëse dhe i padituri kanë qenë në marrëdhënie të vazhdueshme afariste ku pala paditëse e ka furnizuar palën e paditur me mallra të cilat pala e paditur i ka shitur dhe nga kjo shitje ka përfutur në aktivitetin e vet afarist. Si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi afarist me datën 30.09.2015 palët kanë lidhur kontratë për shitblerjen e një pjese të aksioneve të Shoqërisë [“E...“], sh.p.k., në bazë të cilës kontrate dhe vendimit të Kuvendit të Aksionareve, pala paditëse është bërë aksionare me pjesëmarrje prej 51 % të aksioneve të shoqërisë. Me datën 05.05.2016 Kuvendi i Aksionareve ka marrë vendim për ndryshimin e statutit të shoqërisë sipas të cilit rezulton se shoqëria [“E...“] sh.p.k, i është bashkangjitur edhe aksionari i ri [K.R]. Me hyrjen e tij si aksionar është krijuar kjo strukture, paditësi pronar me 34% të aksioneve, i padituri pronar me 33% të aksioneve dhe aksionari i ri [K.R] me 33% të aksioneve të shoqërisë. Qe nga themelimi i shoqërisë së përbashkët, drejtor menaxhues i shoqërisë ka qenë [A.S], ndërsa më datën 08.12.2016 në mbledhjen e Kuvendit të Aksionareve është marrë vendim që të pezullohet aktiviteti tregtar i shoqërisë, si dhe është bërë edhe revokimi i autorizimeve të drejtorit [A.S]. Pala paditëse ka pretenduar se kompania ka realizuar fitim nga aktiviteti afarist i sajë dhe se pala e paditur nuk ka shpërndarë dividendë dhe poashtu ka pretenduar se pala e paditur i ka shkaktuar dëme edhe

përmes shitjes së mallrave të cilat kanë qenë në stokun e shoqërisë, të cilat parat nga shitja i ka përvetësuar. Nga procesi i përpiluar me datën 19.11.2016 i nënshkruar nga paditësi dhe i padituri rrjedh se i padituri ka marrë detyrim që shumën prej 471,648.03€ ta derdhë në llogarinë e shoqërisë ["E..."] sh.p.k. Nga raporti i ekspertizës së punuar nga z. [R.B] rrjedh se për periudhën tre mujore të viti 2015 e deri me datën 31.12.2017, shoqëria ka realizuar dividendë në shumën e përgjithshme prej 44,070.41€. Dividenda nuk është tërhequr në pikëpamje formale nga i padituri sepse ai ka shërbyer për qarkullim në periudhën vijuese, respektivisht për shlyerjen e detyrimeve të subjektit të krijuara nga koha e bashkë themelimit. Subjekti ["E..."] sh.p.k, para shitjes së aksioneve e deri me datën 31.12.2017, ka pas në stok mallin e vetë si në vijim: me datën 30.09.2015 ka pasur vlerën prej 157,274.97€, me datën 31.12.2015 ka pasur vlerën prej 181,740.88€, ndërsa vlera e mallit për vitin 2016 dhe 2017 është zero. Po ashtu eksperti ka konstatuar se me rastin e ekzaminimit të gjendjes lidhur me stokun dhe lëvizjet e stokut përgjatë periudhës kontestuese, nuk është vërtetuar të këtë fshehje apo keqpërdorime të stokut të mallit. Në lidhje me objektin ndërtimorë kontestues, eksperti në raportin plotësues të ekspertizës ka theksuar se [A.S] e ka blere palujtëshmërinë e theksuar me datën 17.09.2012, ndërsa shitja e palujtëshmërisë është bërë me datën 13.07.2016, që do të thotë para se të përpilohet akti kontestuese procesi i datës 19.11.2016. Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se në këtë çështje nuk është vërtetuar me asnjë prove se i padituri ka mbetur në detyrim tek pala paditësen. Prandaj, gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në dispozitën e nenit 8 të LMD-së , si dhe në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 8 të LMD-së i cili përcakton se *"pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre"*. Paditësi ka pretenduar se i padituri e ka tërhequr dividendën dhe nuk e ka ndarë atë me paditësin, mirëpo kjo gjykate vlerëson se në këtë çështje është vërtetuar se dividenda është përdorë për nevojat e shoqërisë Tregtare ["E..."] për shlyerjen e detyrimeve dhe për lehtësimin e qarkullimit financiar për vitet vijuese, por në asnjë rast si përvetësim për interesin e të paditurit. Po ashtu nga ekspertiza financiare të punuar nga z. [R.B] i cili ka theksuar se nuk është vërtetuar asnjë fshehje e stoqeve të mallrave apo ndonjë mënyrë tjetër e keq përdorimit të tyre.

Gjykata Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e paditësit se pala e paditur në cilësi të drejtorit menaxhuese nuk ka bërë shpërndarjen e dividendes dhe se në emër të kësaj mos shpërndarjes është në detyrim ndaj tij. Mirëpo duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe në raportin e ekspertizës

financiare është vërtetuar se dividenda nuk është tërhequr në pikëpamje formale nga i padituri si menaxheri por ka shërbyer për qarkullimin në periudhën vijuese, respektivisht për shlyerjen e detyrimeve të subjekteve të krijuara nga koha e bashkë themelimit të shoqërisë.

Kjo gjykate vlerëson marrëveshja në mes paditësit dhe të paditurit, e përpiluar me datë 19.11.2016, nuk provon ndonjë detyrim konkret të paditurit nga shkak se, në referatin e kësaj shkrese askund nuk ceket detyrim i caktuar i z. [A.S], por theksohet si detyrim i shoqërisë ["E..."] dhe [A.S], pa u caktuar shuma e saktë e detyrimit të z. [A.S]. Me tej theksohet se: palët ranë dakord që shumën prej 471,687.03 €, do ta legalizojnë nëpërmjet vetëdeklarimit në shoqëritë EurolabKosova, ose me faturim nga shoqëritë ["E..."] dhe shoqëria [E2...], nga e cila rrjedh se palët kanë pasur qëllim që në llogarinë e ["E..."] të deponohen 471,687.03 €, përmes deponimit apo përmes faturimit nga dy shoqëritë e theksuara, por nuk theksohet se cili është burimi i këtyre mjeteve respektivisht nga kush do të sigurohen këto mjete. Edhe pse me tej theksohet se 471,687.03 €, do të derdhen nga [A.S] në llogarinë e shoqërisë ["E..."], nuk ceket askund që këto mjete do të derdhen nga kapitali vetanak i z. [A.S], prandaj nuk është e qartë nëse me këtë klauzolë autorizohet z.[A.S] që në cilësi të drejtorit ti kryejë veprimet e bartjes së mjeteve apo është detyrim i tij personal që t'i sigurojë këto mjete. Më tej, në pikën C) theksohet se: në rast se veprimet e sipërcekura nga pika b) nuk realizohen do të përpilojnë kontratë huajë dhe reciprokisht deklaratë noteriale për pranimin e borxhit në shumën prej 471,687.03 €, përsëri pa u cekur se ndërmjet kujt do të lidhet kontrata e huasë dhe kush do ta pranojë borxhin andaj nuk mund të konstatohet me asnjë element se z. [A.S] personalisht ka ndonjë detyrim sipas kësaj shkrese të përpiluar. E njëjta situatë përsëritet edhe në pikën D- ku theksohen propozimet e z. [A.S], lidhur me arkëtimet dhe ndarjet e mjeteve, po nuk theksohet qartë se për çfarë depo behet fjalë dhe për cilat aksione, të cilës shoqëri. Për më tepër Kontrata e noterizuar e paraparë me këtë dokument, nuk është realizuar asnjëherë përkundër faktit se marrëveshja nga ky dokument nuk është realizuar.

Bazuar në të lartcekurat Gjykata e Apelit vlerëson se, dokumenti mbi të cilin paditësin e bazon kërkesëpadinë e tij, nuk përmban elementet e një kontrate e cila do të krijonte detyrime për palët, detyrimet e cekura nuk janë të qarta andaj mbi bazën e këtij dokumenti nuk mund të përcaktohet ndonjë detyrim konkret i z. [A.S] ndërsa konstatimet dhe detyrimet që rrjedhin nga ky dokument, sipas konstatimeve nga ekspertiza financiare, nuk përputhen me dokumentacionin financiar të shoqërisë ["E..."] sh.p.k. Bazuar në të sipërcekurat, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, të gjitha çështjet e cekura në këtë dokument janë konfuze, të pabazuara në dokumente financiare dhe dokumente tjera përcjellëse, andaj mund të konkludohet se transaksionet e parapara janë theksuar në atë mënyrë të paqartë qëllimisht për të mbuluar transaksione tjera reale apo për të arritur qëllime tjera afariste të padeklaruara në dokument, dhe rrjedhimisht përbëjnë transaksione respektivisht deklarime fiktive. Prandaj, duke iu referuar nenit 50 par.1 të LMD, kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret dokumenti i datës 19.11.2016, përbën marrëveshje fiktive e cila nuk ka efekt juridik ndërmjet palëve kontraktuese. Meqenëse paditësi kërkesën e tij e bazon në këtë dokument ndërsa nuk ka ofruar prova tjera bindëse më të cilat do ta

argumentonte bazueshmërinë e kërkesëpadisë, kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret nuk është vërtetuar obligimi i të paditurës ndaj paditësit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e palës paditëse lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike

Ae.nr.152/2020, dt.13.10.2021

KRYETARI I KOLEGJIT,

Mahir Tutuli, d. v.

